



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 356/2 Prot

Gramsh më 24/01 / 2019

VENDIM  
Nr 07 Date 23 / 01 / 2019

MBI

KRITERET E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN  
EKONOMIKE DERINË 6%.

Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 23 / 01 / 2019, pasi mori ne shqyrtim Relacionin e Drejtorise Ekonomike ,Sektori Mireqenies dhe Kujdesit Social “ Mbi kriteret e perdorimit te fondit te kushtezuar per bllok-ndihmen ekonomike deri ne 6%” mbeshetur ne Ligjin Nr 9355 dt 10.03.2005 “Per ndihmen dhe Sherbimet Shoqerore”i ndryshuar ,Neni 21; Ligjin Nr. 139/2015 date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore”neni 8,pika 2;neni 9 ,pika 1.1/a dhe 1.1/b: neni 54 pika ( k) dhe (n);si dhe ne mbeshetje te udhezimit nr.5,date 17.02.2017,

**VENDOSI:**

1.Te miratojë kriteret mbi përdorimin të fondit te kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në6% si me poshte:

- Te jene familje me kryefamiljare gra.
- Te jene familje ne gjendje te dobet ekonomike.
- Te jene familje me shume anëtare .
- Te jene familje me femijë jetim ne kujdestari .
- Te jene familje me probleme sociale.

2-Nuk mund te perfitojne ne baze te udhezimit nr.5 date 17.02.2017 familjet te cilat nuk kane aplikuar per ndihme ekonomike sipas Vendimit nr.955, date 07.12.2016 te Keshillit te Ministrave.”Per percaktimin e kriteret,procedurave, dokumentacoinit dhe mases se perfitimit te ndihmes ekonomike” si dhe familjet qe jane perjashtuar nga sistemi per mosdeklarim te pages,pensioneve,mosperputhje me gjendjen civile dhe me zyren e punes,me perjashtim kur keto penalizime nuk jane per faj te qytetareve por per shkak te afateve te nderlidhjes se sistemeve elektronike me njeri tjetrin.

3-Per Zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Sektori I Mbrojtjes Sociale ,Bashkia Gramsh.  
Ky vendim hyne ne fuqi 10 dite pas shpalljes..

Sekretari Keshillit  
Astrit Duzha

Konc .A.Duzha  
Konfirmoi:  
Miratoi:  
Dosja \_\_\_\_\_  
Afati \_\_\_\_\_

Kryetari Keshillit  
Shkelqim Hoxha

